



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.41/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia - Ymeri dhe Ragip Namani, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - administrative të dënuarit: G. B. nga i ati A. dhe e ëma M., e gjinisë M., i lindur më datë..., në fshatin B., Komuna S., me vendbanim në P. rr. ..., duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.531/24, të datës 14.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të dënuarit: G. B. nga i ati A. dhe e ëma M., e gjinisë M., i lindur më datë ..., në fshatin B., Komuna S., me vendbanim në P. rr. ..., e paraqitur kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.531/24, të datës 14.10.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.531/24, të datës 14.10.2024, është vendosur: I. Refuzohet kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit G.B. nga i ati A. dhe e ëma M., e gjinisë M., i lindur më datë ..., në fshatin B., Komuna S., me vendbanim në P. rr. ..., objekti ..., kati ..., nr...., me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. II. Kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 5 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, i dënuari me kohë ka paraqitur ankesë, pa përmendur ndonjë bazë ligjore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë të bazuar ankesën e parashtruesit, dhe të pranohet kërkesa për lirim me kusht.

Paneli për Lirim me Kusht, me përgjigjen në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa dhe të vërtetohet aktvendimi i kundërshtuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12 të Ligjit nr. 08/L-132, për Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, shqyrtoi ankesën e paraqitur nga i dënuari, aktvendimin e ankimuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prizren, PKR.nr.99/22, të datës 18.07.2022, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.503/23, të datës 12.04.2023, G. B. është shpall fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-

së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 500€.

Më datë 17.09.2024, i dënuari përmes Institucionit Korrektues ku është në mbajtje të dënimit me burg, ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht me arsyetimin se gjatë mbajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Në seancën e mbajtur me 14.10.2024, Paneli pasi e shqyrtoi dosjen e të dënuarit, përkatësisht raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Institucionit Korrektues, Deklaratë premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit Nr. 08/L-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenin 15 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes të njëjtën e ka refuzuar si të pabazuar.

Në arsyetim të vendimit Paneli për Lirim me Kusht, ka theksuar se: paneli vlerësoj plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe rrethanat e tjera që ndikojnë në lirimin me kusht të personit të dënuar që parashihen në nenin 11 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht. Rrethanat përfshijnë: përshkrimin e personit të dënuar për veprën penale, gjendjen fizike dhe psikike të tij, qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës, sjelljen e mirë gjatë burgimit, përkatësisht të dhënat nëse është shqiptuar masë disiplinore ndaj tij gjatë vuajtjes së dënimit, rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore, planet e të dënuarit pas lirimit, pranimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ShSK, ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për shoqërinë/komunitetin, programet rehabilituese të ndjekura nga personi i dënuar, vlerësimin e progresit të arritur te i dënuari në planin individual të rehabilitimit dhe rrethanat e tjera të vlerësuara nga paneli që tregojnë se i njëjti nuk do të kryej vepër penale.

Paneli pas shqyrtimit të dosjes, vlerësimit të kushteve dhe rrethanave të caktuara në rregullore, konstaton se të dënuarit i duhet ende kohë për të mbajtur dënimin në mënyrë që të vlerësohet sjellja e të njëjtit. Kategorizimi se ekziston rrezikshmëria tregon një indikator tjetër që të dënuarit i duhet ende kohë për të vlerësuar rrezikshmërinë e mbetur. Po ashtu, ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese nuk ka dhënë konstatim se është arritur risocializimi, andaj marr parasysh faktin se risocializimi është një proces që siguron se i dënuari është i gatshëm që të ri-integrohet në shoqëri pa rrezik për t'u kthyer në veprime të paligjshme dhe mungesa e një konstatimi të tillë nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese tregon se procesi i risocializimit nuk ka përfunduar. Prandaj duke marr parasysh të gjitha këto rrethana, Paneli ka ardhur në përfundim se nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penale i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua për periudhën kohore prej 5 muaj dhe mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e atakuar, pasi që i njëjti është në tërësi i bazuar në ligj, dhe me këtë rast u pranuan si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të Panelit për

Lirim me Kusht, të theksuara në tërësi si në këtë vendim. Refuzimi i kërkesës për lirim me kusht, të paraqitur nga i dënuari është i mbështetur në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe në Rregulloren nr. 01/39, duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat që përcaktohen me dispozitat ligjore nga ligjet e sipërcituar, dhe nga rregullorja nr. 01/39. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ende nuk janë plotësuar të gjitha kushtet në mënyrë kumulative që i dënuari të lirohet me kusht, kjo për faktin se ende nuk është bërë risocializimi i tij, në mënyrë të plotë ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore. Në këtë rast Paneli për Lirim me Kusht, me të drejtë e ka refuzuar kërkesën e palës së dënuar, ku të njëjtit i ka dhënë mundësinë që pas kalimit të afatit prej 5 muaj, të ketë mundësi të përsërisë kërkesën për lirim me kusht. Refuzimi i kërkesës nga ana e Panelit për Lirim me Kusht, është bërë pas vlerësimit të secilit kriter të paraparë me nenin 14 paragrafi 1 pikën 1.1 të Rregullores, nr.39, mbi Organizimin dhe Funksionimin e Panelit me Lirim me Kusht, andaj një vendim të tillë e mbështet edhe kjo gjykatë.

Në këtë kuptim u refuzuan si të pa bazuara pretendimet e të dënuarit, për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, për faktin se Paneli për Lirim me Kusht, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Në vendosjen lidhur me kërkesat për lirim me kusht lidhur me të dënuarit, Paneli për Lirim me Kusht, nga të gjitha pikat e shqyrtimit të kriterëve të parapara me nenin 14 paragrafi 1 pikën 1.1 të Rregullores, nr.39 mbi Organizimin dhe Funksionimin e Panelit me Lirim me Kusht, me theks të veçantë duhet të ketë parasysh peshën e veprave penale të kryer nga i dënuari, andaj duke pas parasysh se veprën penale të kryer nga i dënuari, ku e njëjta është përfshirë në dashjen e tij, vlera e dëmit e shkaktuar është e lartë, sipas raportit të ekipi profesionist të Qendrës Korrektuese, nuk ka konstatim nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese se është arritur risocializimi i plotë, i cili konstatim për gjykatën është shumë i rëndësishëm, për çka erdhi në përfundim se ende nuk janë plotësuar të gjitha kushtet për lirimin e të njëjtit me kusht.

Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi konstatimin e Panelit për Lirim me Kusht, në vendimin e ankimuar, dhe se refuzimi i kërkesës nuk prejudikon mënyrën e vendosjes në rast të përsëritjes së kërkesës pas kalimit të afatit prej 5 muaj, ashtu siç është përcaktuar në vendimin e panelit, andaj pretendimet ankimore të paraqitura në këtë drejtim u vlerësuan si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura më lart, e në bazë të nenit 117 paragrafi 11, 12, të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.41/2024, më datë 20.11.2024.

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi